



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

KËSHILLI BASHKIAK BERAT

PROJEKT-VENDIM  
Nr. 34, datë 01/06 2022

MBI AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË BASHKISË BERAT PËR TË  
NËNSHKRUAR KONTRATËN E GRANTIT PËR PROJEKTIN 'SHËRBIME  
MULTIFUNKSIONALE NË SEKTORIN E ARSIMIT' FINANCUAR NGA  
PROGRAMI EU4MUNICIPALITIES

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 8, 9/1 gërma a, neni 23, neni 25, 54, 64, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, VKB Nr. 94 date 28.12.2021 " Mbi miratimin e buxhetit te Bashkisë Berat per vitin 2022 dhe PBA perfundimtare 2022-2024", VKB nr. 24 date 06.04.2022 "Per miratimin e tavaneve pergatitore te programit buxhetor afatmesem", Këshilli Bashkiak

V E N D O S I :

1. Miratimin e autorizimit të Kryetarit të Bashkisë Berat për të nënshkruar në emër të Bashkisë Berat Kontratën e Grantit të Projektit 'Shërbime multifunksionale në Sektorin e Arsimit' financuar nga Programi EU4Municipalities".
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Integritit European dhe Projekteve.

K R Y E T A R

Ervin Ceca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
KËSHILLI BASHKIAK BERAT

PROJEKT-VENDIM

Nr. 35, datë 01/06 2022

MBI MIRATIMIN E KONTRIBUTIT TË BASHKISË BERAT PËR PROJEKTIN  
'SHËRBIME MULTIFUNKSIONALE NË SEKTORIN E ARSIMIT''FINANCUAR  
NGA PROGRAMI EU4MUNICIPALITIES.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 8, 9/1 gërma a, neni 23, neni 25, 54, 64, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, VKB Nr. 94 date 28.12.2021 '' Mbi miratimin e buxhetit te Bashkisë Berat per vitin 2022 dhe PBA perfundimtare 2022-2024'', VKB nr. 24 date 06.04.2022 "Per miratimin e tavaneve pergatitore te programit buxhetor afatmesem'', Këshilli Bashkiak

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e kontributit të Bashkisë Berat për mbulimin e kostove të TVSH (20%) të Projektit 'Shërbime multifunksionale në Sektorin e Arsimit''financuar nga Programit EU4Municipalities'', në shumën 36,000 euro.
2. Miratimin e kontributit të Bashkisë Berat për mbulimin e bashkëfinancimit prej 20,000 euro ( 10%) të shumës totale të Projektit ''Shërbime multifunksionale në Sektorin e Arsimit''financuar nga Programi EU4Municipalities'', kosto e cila do të mbulohet me kontributin e kosto stafi të Bashkisë Berat, të cilët do punojnë për Projektin.
3. Kontributi i Bashkisë për bashkëfinancim 36,000 euro do të parashikohet në buxhetin e vitit 2023 dhe PBA 2023-2025, në funksionin e arsimit 09.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Integritimit European dhe Projekteve.

**K R Y E T A R**

Ervin Ceca